



VENDIM

Nr. 66 Datë 28.09.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË
SHOQËRISË “EGL ALBANIA” SH.A NË AKTIVITETIN E
TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 13, pikat 1, gërma “d”, dhe neni 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.09.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EGL Albania” sh.a për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

dhe Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “EGL Albania” sh.a plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “b” dhe “c”) eshte paraqitur dhe plotësuar ne menyre korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “EGL Albania” sh.a në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 63 Datë 28.09.2009

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË
SHOQËRISË “EGL ALBANIA” SH.A NË AKTIVITETIN E
TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____